



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1696 Prot.

Tiranë, më 24.12 2018

VENDIM Nr. 279, datë 19.12.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12, datë 19.12.2018, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të projektit "Godinë banimi dhe shërbime 1-5-6 kate mbi tokë me 1 kat nëntokë garazh" Lagjia Nr. 3, Rr."Ramazan Jella" në zonë arkeologjike "B" Durrës -subjekti "DESLA" shp.k., relacionin për potencialin arkeologjik të zonës dhe Konceptin e sondazheve, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë relacionin për potencialin arkeologjik dhe konceptin e sondazheve arkeologjike të zonës, ku do të zhvillohet projekti "Godinë banimi dhe shërbime 1-5-6 kate mbi tokë me 1 kat nëntokë garazh" Lagjia Nr. 3, Rr."Ramazan Jella" në zonë arkeologjike "B" Durrës -subjekti "DESLA" shp.k., paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.
2. Subjekti "DESLA" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë sondazhet arkeologjike, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori "DESLA" sh.p.k. duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Investitori "DESLA" sh.p.k. si dhe subjekti i licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhet arkeologjike, në mbështetje të legjislacionit në fuqi dhe akt-marrëveshjes tre palëshe të sipërcituar, janë të detyruar të marrin të gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazheve, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me to.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO TURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Webfaqja: kka.gov.al